



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURISË  
Nr. 175 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË  
Nr. 673 Prot.

## AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt marrëveshje, ndërmjet:

**Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj.Fatmira Laska;

dhe

**Këshillit të Lartë të Drejtësisë**, i cili më poshtë do të quhet **KLD**, i përfaqësuar nga Zëvendëskryetari, z.Illir Panda.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt-marrëveshje, me qëllim:

realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. KLD anagazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive cdo informacion apo të dhënë që disponon ky institucion dhe ato të vartësisë, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

3. KLD do të caktojë një strukturë të posacme si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. KLD merr përsipër që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

5. Në raste të caktuara, me miratim të përbashkët të titullarëve të të dy institucioneve, mund të caktohen grupe të përbashkëta inspektorësh për kontrollin e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve. Një gjë e tillë nuk ndalon që secili prej dy institucioneve të zhvillojnë kontrolle dhe hetime administrative në mënyrë të pavarur, në zbatim të ligjit.


6. Kjo marrëveshje nëshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

**KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË**

**Inspektori i Përgjithshëm**

**FATMIRA LASKA**



**Zëvendëskryetari**

**ILIR PANDA**

